



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 18 prot.

Kamëz, më 19.02.2021

V E N D I M

Nr. 15 Datë 11.02.2021

MBI

Miratimin e shumës financiare prej 3,288,000 (tre milion e dyqind e tetë dhjetë e tetë mijë) lekë, për periudhën Janar 2021 deri në përfundimin e rindërtimit të banesës, për familjet që banojnë në Bashkinë Kamëz, dhe që përfitojnë "Bonus qiraje", dërgimin për bashkëfinancim (80%-20%) në masën prej 2,630,400 (dy milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e katërqind) lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe me vlerë 657,600 (gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas Prog 06180 Art 606.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.02.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendimin Nr.15 Datë 15.02.2021, në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr. 22/2018 "Për programet sociale të strehimit", Aktin Normativ nr.37 datë 24.12.2020 "Për një ndryshim në Aktin Normativ nr.8, datë 07.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019" si dhe relacionit të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit, Këshilli Bashkiak Kamëz :

V E N D O S I :

1. Miratimin e shumës financiare prej 3,288,000 (tre milion e dyqind e tetë dhjetë e tetë mijë) lekë, për periudhën Janar 2021 deri në përfundimin e rindërtimit të banesës, për familjet që banojnë në Bashkinë Kamëz, dhe që përfitojnë "Bonus qiraje", dërgimin për bashkëfinancim (80%-20%) në masën prej 2,630,400 (dy milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e katërqind) lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe me vlerë 657,600 (gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas Prog 06180 Art 606.
2. Pagesa për secilën familje përfituese të bonusit të strehimit do të jetë për periudhën Shkurt 2021 deri në rindërtimin e banesës.
3. Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/Kryetar Këshilli

Ali DAUTI